



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo

Autoriteti i Aviacionit Civil
Autoritet Civilnog Vazduhoplovstva
Civil Aviation Authority

Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil i Republikës së Kosovës,

Në mbështetje të nenit 21.3 dhe nenit 40.3 të Ligjit nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil,

Me qëllim të përcaktimit të kërkesave për regjistrimin e mjeteve ajrore në Republikën e Kosovës dhe rregullimit të aplikimit të shenjave të nacionalitetit dhe të regjistrimit në përputhje me Aneksin 7 të Konventës mbi Aviacionin Civil Ndërkombëtar të 7 dhjetorit 1944,

Nxjerr këtë:

RREGULLORE Nr. 2/2009 PËR

REGJISTRIMIN DHE SHENJËZIMIN E MJETEVE AJRORE

KAPITULLI 1 **TË PËRGJITHSHME**

Neni 1 **Fushëveprimi**

1.1 Kjo rregullore parashtron kërkesat për regjistrimin dhe shenjëzimin e mjeteve ajrore civile ashtu siç kërkohet me dispozitat e Titullit III, Pjesës 2, Kreut 1 të Ligjit nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil.

1.2 Kjo rregullore nuk vlen për balonët meteorologjik me pilot që përdorën ekskluzivisht për qëllime meteorologjike apo për balonët e lirë pa pilot dhe pa ngarkesë.

Neni 2 **Përkufizimet**

Për qëllime të kësaj rregulloreje, vlejné përkufizimet vijuese:

- a) **Aeroplan** do të thotë mjet ajror më i rëndë se ajri që punon me forcë shtytëse dhe ngritjen e tij në fluturim e fiton kryesisht nga reaksionet aerodinamike në sipërfaqe të cilat mbesin të fiksuara në kushte të caktuara të fluturimit.
- b) **Mjet ajror** do të thotë çfarëdo makine e cila siguron mbështetjen në atmosferë nga reaksionet e ajrit përveç reaksioneve të ajrit kundrejt sipërfaqes së tokës. Shprehja “mjet ajror”, kur përdoret në këtë Rregullore iu referohet vetëm mjeteve ajrore civile dhe nuk përfshinë mjetet ajrore që përdoren për qëllime shtetërore ose publike.
- c) **Anije ajrore (Zepelin)** do të thotë mjet ajror më i lehtë se ajri me forcë shtytëse.
- d) **Autoritet** do të thotë Autoriteti i Aviacionit Civil i Republikës së Kosovës.
- e) **Balon** do të thotë mjet ajror që nuk ka forcë shtytëse dhe që është më i lehtë se ajri.
- f) **Material rezistues ndaj zjarrit** do të thotë material i aftë t’i rezistojë nxehjes së po aq sa, apo më mirë se çeliku, kur dimensionet në të dyja rastet janë adekuate për qëllim specifik.
- g) **Velore (glajder)** do të thotë mjet ajror pa forcë shtytëse e që është më i rëndë se ajri, i cili forcën ngritëse në fluturim e fiton kryesisht nga reaksionet aerodinamike në sipërfaqe të cilat mbesin të fiksuara në kushte të caktuara të fluturimit.
- h) **Xhiroplan** do të thotë cilido mjet ajror më i rëndë se ajri që mbështetet në fluturim nga reaksionet e ajrit në një apo më shumë rotorë të cilët rrotullohen lirshëm në boshtet kryesor vertikale.
- i) **Mjet ajror më i rëndë se ajri** do të thotë çfarëdo mjeti ajror i cili forcën ngritëse në fluturim e fiton kryesisht nga forcat aerodinamike.
- j) **Helikopter** do të thotë mjet ajror më i rëndë se ajri i mbështetur në fluturim kryesisht nga reaksionet e ajrit në një apo më shumë rotorë të shtyrë me forcë në boshtet kryesore vertikale.
- k) **Mjet ajror më i lehtë se ajri** do të thotë çfarëdo mjeti ajror të mbështetur në ajër kryesisht nga pluskimi i tij në ajër.
- l) **Ngritje me forcë** do të thotë mjet ajror më i rëndë se ajri i aftë për ngritje vertikale, aterrim vertikal dhe fluturim me shpejtësi të ulët i cili varet kryesisht nga mekanizmat ngritës të shtyrë nga motorët apo nga vrulli i motorit për ngritje gjatë këtyre regjimeve të fluturimit dhe nga profili(let) aerodinamik jo-rrotullues për ngritje gjatë fluturimit horizontal.

- m) **Rotorplan** do të thotë mjet ajror me forcë shtytëse më i rëndë se ajri i mbështetur në fluturim nga reaksionet e ajrit në një apo më shumë rotorë.
- n) **Shtet i regjistrimit** do të thotë Shteti në regjistrin e të cilit është regjistruar mjeti ajror.

KAPITULLI 2 KËRKESAT PËR REGJISTRIM

Neni 3 Të përgjithshme

- 3.1 Asnjë person nuk mund të operojë një mjet ajror civil i cili është i kualifikuar për regjistrim sipas ligjeve të Republikës së Kosovës, përveç nëse është regjistruar nga pronari apo operatori i tij sipas dispozitave të kësaj rregulloreje dhe Autoriteti të ketë lëshuar një Certifikatë Regjistrimi për atë mjet ajror e cila duhet të bartet në të gjatë të gjitha operacioneve.
- 3.2 Certifikata e regjistrimit duhet të jetë në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze.
- 3.3 Certifikata e regjistrimit lëshohet nga Autoriteti në formën e parashikuar me Aneksin I të kësaj rregulloreje dhe me madhësi të përcaktuara nga Autoriteti.

Neni 4 Përshtatshmëria për regjistrim

- 4.1 Një mjet ajror mund të regjistrohet në Republikën e Kosovës vetëm nëse:
- a) Është në pronësi dhe/ose operohet nga:
 - i) Një shtetas i Republikës së Kosovës apo nga personi i cili është me kombësi apo shtetas i BE-së apo i njërit nga shtetet anëtare të ZPEA-së,
 - ii) Një shtetas i një shteti tjetër i cili është pranuar ligjërisht për qëndrim të përhershëm në Republikën e Kosovës,
 - iii) Një korporatë e organizuar në mënyrë ligjore dhe e cila ushtron veprimtarinë sipas ligjeve të Republikës së Kosovës dhe mjeti ajror është me bazë në Republikën e Kosovës dhe përdoret kryesisht aty, ose
 - iv) Një subjekt qeveritar i Republikës së Kosovës apo i ndonjë nën-divizioni politik të saj,
 - b) Nuk është regjistruar me ligjet e asnjë shteti tjetër.

4.2 Në rast të marrëveshjeve afatshkurtra të lizingut për të plotësuar nevojat e përkohshme të një transportuesi ajror apo në rrethana të jashtëzakonshme, Autoriteti mund të bëjë përjashtime nga kërkesat e nenit 40.2 a. të Ligjit nr. 03/L-051 për Aviacion civil, sipas kushteve të Rregullores së Këshillit (EEC) nr. 2407/92 të 23 korrikut 1992 mbi licencimin e transportuesve ajror.

Neni 5 Aplikimi

5.1 Personi i cili dëshiron të regjistrojë një mjet ajror në Republikën e Kosovës duhet të parashtojë një aplikacion për regjistrim të mjetit ajror në formën dhe mënyrën e pranueshme për Autoritetin. Çdo aplikacion duhet:

- a) Të vërtetojë përputhshmërinë me nenin 4;
- b) Të tregojë dëshmi të pronësisë; dhe
- c) Të nënshkruhet me ngjyrë shkrimi.

5.2 Pasi që aplikuesi të ketë plotësuar të gjitha kërkesat për regjistrim, një Certifikatë e Regjistrimit do t'i lëshohet parashtruesit të kërkesës, nga ana e Autoritetit.

5.3 Së bashku me aplikacionin për regjistrimin e mjetit ajror Autoritetit i parashtrohet taksa për regjistrim e përcaktuar me ligj.

Neni 6 Regjistri i mjeteve ajrore

6.1 Autoriteti duhet të mbajë një regjistër të mjeteve ajrore që tregon për çdo mjet ajror të regjistruar informatat e cekura në certifikatën e regjistrimit të mjetit ajror dhe çfarëdo informate tjetër të kërkuar nga Autoriteti.

6.2 Në bazë të kërkesës, Republika e Kosovës i ofron një shteti kontraktues të ICAO-së apo vetë ICAO-së informata lidhur me regjistrimin e mjeteve ajrore dhe/ose pronësinë e ndonjë mjeti ajror të veçantë të regjistruar në Republikën e Kosovës.

KAPITULLI 3 SHENJAT E NACIONALITETIT DHE REGJISTRIMIT

Neni 7 Të përgjithshme

7.1 Asnjë person nuk mund të operojë mjetin ajror civil të regjistruar në Republikën e Kosovës nëse në atë mjet ajror nuk janë ekspozuar shenjat e nacionalitetit dhe regjistrimit në përputhje me kërkesat e këtij neni.

7.2 Përveç nëse autorizohet ndryshe nga Autoriteti, asnjë person nuk mund të vendosë në ndonjë mjet ajror ndonjë dizajn, shenjë apo simbol i cili i ndryshon apo ngatërron shenjat e nacionalitetit dhe ato të regjistrimit.

7.3 Shenjat e përhershme të nacionalitetit dhe regjistrimit të mjetit ajror duhet:

- a) Të ngjyrosen në mjet ajror apo të fiksohen në forma tjera duke siguruar një shkallë të njëjtë të qëndrueshmërisë;
- b) Të mos kenë ornamente;
- c) Të kenë ngjyrë që është në kontrast me sfondin;
- d) Të jenë të lexueshme; dhe
- e) Të mbahen të pastra dhe të dukshme gjatë tërë kohës.

Neni 8

Ekspozimi i shenjave: të përgjithshme

8.1 Shenja e nacionalitetit e mjeteve ajrore të regjistruara në Kosovë është KS.

8.2 Autoriteti duhet ta njoftojë Sekretarin e përgjithshëm të Organizatës Ndërkombëtare të Aviacionit Civil lidhur me shenjën e nacionalitetit të mjeteve ajrore të Republikës së Kosovës.

8.3 Çdo pronar në mjetin e tij ajror duhet të ekspozojë shenjat që përbëhen nga shenja e nacionalitetit KS dhe nga shenja e regjistrimit, e cila duhet të ketë tri shkronja të shtypit të shkruara me alfabet romak që i caktohen mjetit ajror nga Autoriteti. Shkronjat duhet të jenë pa ornamente dhe ndërmjet shenjës së nacionalitetit dhe asaj të regjistrimit duhet të vendoset një vizë ndarëse.

8.4 Nuk duhet të akordohen nga Autoriteti, kombinimet e shkronjave të përdorura për shenjën e regjistrimit të cilat do të mund të ngatërroheshin me kombinimet pesë-shkronjëshe që përdoren në Kodin Ndërkombëtar të Sinjaleve, Pjesa II, me kombinimet tre-shkronjëshe që fillojnë me Q të cilat përdoren në Kodin Q, dhe me sinjalin për ndihmë SOS, apo me sinjale të tjera urgjente.

Neni 9

Madhësia e shenjave

9.1 Çdo pronar i mjetit ajror duhet të ekspozojë në mjet ajror shenjat të cilat i përmbushin kërkesat e madhësisë të përcaktuara me këtë nen.

9.2 Lartësia. Shkronjat e shenjave duhet të jenë me lartësi të njëjtë dhe:

- a) Në mjetin ajror më të rëndë se ajri duhet të jenë së paku:
 - i) 50 centimetra të larta nëse janë të vendosura në krah, dhe
 - ii) 30 centimetra të larta nëse janë të vendosura në trup (apo konstruksion të ngjashëm) dhe në sipërfaqet vertikale të bishtit;
- b) Në mjetin ajror më të lehtë se ajri përveç balonëve të lirë pa pilot duhet të jenë së paku 50 centimetra të larta.
- c) Në balonët e lirë pa pilot duhet të përcaktohen nga Autoriteti, duke marrë parasysh madhësinë e ngarkesës në të cilën fiksohet pllaka e identifikimit.

9.3 Gjerësia. Shkronjat duhet të jenë të gjëra sa dy të tretat e lartësisë, përveç shkronjës "I", e cila duhet të jetë e gjerë sa një e gjashta e lartësisë së sajë.

9.4 Trashësia. Shkronjat duhet të formohen nga vijat e plota me trashësi sa një e gjashta e lartësisë së shkronjave.

9.5 Distanca. Distanca ndërmjet cilësdo shkronjë nuk guxon të jetë më e vogël se një e katërta e gjerësisë së shkronjës.

9.6 Njëtrajtshmëria. Shenjat për mjetet ajrore me krah fiks që kërkohen me këtë Rregullore duhet të kenë të njëjtën lartësi, gjerësi, trashësi dhe distancë në të dyja anët e mjetit ajror.

Neni 10

Lokacioni i shenjave në mjetet ajrore më të rënda se ajri

10.1 Pronari i mjetit ajror me krah të fiksuar duhet të ekspozojë shenjat një herë në sipërfaqen e poshtme të konstruksionit të krahut si në vijim:

- a) Ato duhet të vendosen në gjysmën e majtë të sipërfaqes së poshtme të konstruksionit së krahut përveç nëse ato shtrihen në tërë sipërfaqen e poshtme të konstruksionit të krahut.
- b) Sa më shumë që është e mundur, shenjat duhet të vendosen në distancë të barabartë nga tehu i përparmë dhe i pasëm i krahëve.
- c) Pjesa e epërme e shkronjave duhet të vendoset drejt tehut të përparmë të krahut.

10.2 Në mjetet ajrore më të rënda se ajri me trup (apo konstruksion të ngjashëm) dhe/ose me sipërfaqe vertikale të bishtit, shenjat duhet të vendosen ose në sipërfaqet vertikale të bishtit ose në anët e trupit si në vijim:

- a) Nëse ekspozohen në sipërfaqet vertikale të bishtit, ato vendosen horizontalisht në të dy sipërfaqet e një bishti vertikal të vetëm apo në sipërfaqet e jashtme të bishtit vertikal të shumëfishtë.
- b) Nëse ekspozohen në sipërfaqe të trupit, ato vendosen horizontalisht në të dyja anët e trupit ndërmjet tehut të pasëm të krahëve dhe tehut të përparmë të stabilizatorit horizontal.
- c) Nëse ndodhen mbështjellës të motorëve apo shtojca të tjera në zonën e përshkruar në paragrafin 10.2 b) dhe janë pjesë përbërëse e mjetit ajror, shenjat mund të paraqiten në ata mbështjellës apo ato shtojca.

Neni 11

Lokacioni i shenjave në mjetet ajrore më të lehta se ajri

11.1 Anijet ajrore (Zepelin). Pronari duhet t'i vendosë shenjat në anije ajrore ashtu që ato të paraqiten:

- a) Në trup, të shkruara për së gjati në secilën anë të trupit dhe gjithashtu në sipërfaqen e epërme në vijën simetrike; ose
- b) Në sipërfaqet e stabilizatorëve horizontale dhe vertikale:
 - i) Për stabilizatorin horizontal, duhet të vendosen në gjysmën e djathtë të sipërfaqes së epërme dhe në gjysmën e majtë të sipërfaqes së poshtme, ku pjesa e epërme e shkronjave vendoset drejt tehut të përparmë; dhe
 - ii) Për stabilizatorin vertikal, duhet të vendosen në secilën anë të gjysmës së poshtme të stabilizatorit, ku shkronjat vendosen horizontalisht.

11.2 Balonët sferik (përveç atyre të lirë pa pilot). Pronari duhet t'i vendosë shenjat në dy vende diametralisht përballë njëri tjetrit dhe që janë afër perimetrit maksimal horizontal të balonit.

11.3 Balonët jo-sferik (përveç atyre të lirë pa pilot). Pronari duhet t'i vendosë shenjat në secilën anë, afër diametrit maksimal të balonit menjëherë mbi shiritin për litarë apo mbi pikat e ngjitjes së kablllove për mbajtje të shportës.

11.4 Mjetet ajrore më të lehta se ajri (përveç atyre të lirë pa pilot). Pronari duhet t'i vendosë shenjat anësore që duhet të jenë të dukshme nga anët dhe nga toka.

11.5 Balonët e lirë pa pilot. Pronari duhet t'i vendosë shenjat ashtu që ato të paraqiten në pllakën për identifikim.

Neni 12

Rastet e veçanta për madhësinë dhe lokacionin e shenjave

12.1 Nëse njëra nga sipërfaqet e autorizuar për ekspozimin e shenjave të nevojshme është mjaft e madhe për të ekspozuar shenjat duke përmbytur kërkesat e madhësisë së këtij neni, ndërsa tjetra nuk është, shenjat me madhësi të plotë duhet të vendosen në sipërfaqen më të madhe.

12.2 Nëse asnjëra sipërfaqe nuk ka madhësi të mjaftueshme për shenjat me madhësi të plotë, Autoriteti mund të aprovojë shenja me madhësi sa më të madhe të realizueshme për ekspozim në sipërfaqen më të madhe nga të dyja.

12.3 Nëse, për shkak të konfigurimit të mjetit ajror, nuk është e mundur të shenjzohet mjeti ajror në përputhje me këtë Rregullore, pronari mund të aplikojë tek Autoriteti për ndonjë procedurë tjetër.

Neni 13

Shitja e mjetit ajror: largimi i shenjave

Në rastet kur shitet mjeti ajror i regjistruar në Republikën e Kosovës, mbajtësi i Certifikatës së Regjistrimit duhet të largojë, para dorëzimit të tij tek blerësi, të gjitha shenjat e përkatësisë shtetërore dhe regjistrimit të Republikës së Kosovës, përveç nëse blerësi është një shtetas apo person tjetër juridik siç është përcaktuar në 4.1 a).

Neni 14

Pllaka e nevojshme e identifikimit

Pronari duhet të fiksojë në çdo mjet ajror të regjistruar sipas kësaj Rregulloreje një pllakë identifikimi e cila:

- a) Përmban të dhëna për tipin e mjetit ajror, modelin, numrin serik, shenjën e përkatësisë shtetërore dhe shenjën e regjistrimit; dhe
- b) Është e prodhuar nga metali rezistues ndaj zjarrit apo materiali tjetër rezistues ndaj zjarrit me veçori të përshtatshme fizike; dhe
- c) Është e përforcuar në mjet ajror në një pozitë të dukshme, afër hyrjes kryesore, ose, në rast të balonëve të lirë pa pilot, është e fiksuar në vend të dukshëm në pjesën e jashtme të ngarkesës.

Neni 15


Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi më 22 tetor 2009.

Dritan Gjonbalaj
Drejtori i Përgjithshëm

ANEKSI I

CERTIFIKATA E REGJISTRIMIT

Numri rendor në regjistër: Broj uložaka u registar: Registry Insert Number:		Tipi i mjetit ajror: Tip vazduhoplova: Type of Aircraft:
Republika e Kosovës - Republika Kosovo - Republic of Kosovo Autoriteti i Aviacionit Civil - Autoritet Civilnog Vazduhoplovstva - Civil Aviation Authority		
CERTIFIKATË E REGJISTRIMIT - UVERENJE O REGISTRACIJI - CERTIFICATE OF REGISTRATION		
1. Nacionaliteti dhe shenja e regjistrimit: Nacionalnost i oznaka registracije: Nationality and Registration Mark:	2. Prodhuesi, tipi dhe modeli: Proizvođač, tip i model: Manufacturer, Type & Model:	3. Numri serik i mjetit ajror: Serijski broj vazduhoplova: Aircraft Serial Number:
4. Emri i pronarit - Ime vlasnika - Name of Owner:		
5. Adresa e pronarit - Adresa vlasnika - Address of Owner:		
<p>6. Me këtë vërtetohet se mjete ajror i përshkruar më lart është i regjistruar sipas rregullave në Regjistrin e mjeteve ajrore civile të Republikës së Kosovës, në përputhje me Konventën për aviacionin civil ndërkombëtar të datës 7 dhjetor 1944, Ligjin Nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil dhe rregulloret e nxjerra në përputhje me këtë Ligj.</p> <p>Ovim se potvrđuje da je gore navedeni vazduhoplov upisan u Registar civilnih vazduhoplova Republike Kosova u skladu sa Konvencijom o međunarodnom civilnom vazduhoplovstvu od 7 decembra 1944 godine, Zakonom br. 03/L-051 o Civilnom Vazduhoplovstvu i propisa donesenih na osnovu ovog Zakona.</p> <p>It is hereby certified that the above described aircraft has been duly entered on the Civil Aircraft Register of the Republic of Kosovo in accordance with the Convention on International Civil Aviation dated 7 December 1944, with the Law No. 03/L-051 on Civil Aviation and the regulations issued thereunder.</p>		
Data e lëshimit - Datum izdavanja - Date of Issue:	Vula dhe nënshkrimi - Peçat i potpis - Stamp and Signature:	

